



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

C-IV.-14-0564

Paditësja:

A V, Panqevë

Kundër:

E paditura:

Ndërmarrja Shoqërore “I P”, Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Agim Ramadani”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, më 20 maj 2020, lëshon këtë:

AKTVENDIM

Padia e paditëses konsiderohet e tërhequr.

Rrethanat faktike dhe procedurale:

Më 31 janar 2014 Dhoma e Posaçme ka pranuar ankesë nga Parashtruesja e ankesës kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, me të cilën kërkon pagat e papaguara në shumë prej 2,800.00€ për periudhë të paspecifikuar nga Ndërmarrja Shoqërore “I P”.

Kësaj ankese parashtruesja si provë i ka bashkëngjitur:

- *Kopjen e vendimit të AKP-së sipas kërkesës PRZ034-0272 të datës 27 dhjetor 2013, për refuzimin e kërkesës së paraqitur nga Parashtruesja e ankesës;*
- *Kopjen e letërnjoftimit;*
- *Kopjen e kërkesës së dorëzuar pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së.*

Parashtruesja e ankesës kishte paraqitur kërkesë të afatshme më 26 korrik 2013, për kompensimin e tre pagave të papaguara në shumën prej 2,800.00€ për periudhë të paspecifikuar nga Ndërmarrja Shoqërore "I.P".

Më 27 dhjetor 2013 Agjencia Kosovare e Privatizimit nxjerr vendimin sipas kërkesës PRZ034-0272, me të cilin refuzon kërkesën e parashtrueses së ankesës si të pavlefshme.

AKP-ja e refuzon kërkesën si të pavlefshme duke ju referuar Nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në dhe Nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas Nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24, që parashikon që ‘pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkruar për tre vjet’.

Sipas AKP-së për të ndërprerë parashkrimin kërkesa do të duhej të paraqitej në gjykatë apo ndonjë organ kompetent brenda tre vjetëve nga momenti kur parashtrueses i ka lindur e drejta për të kërkuar pagat e papaguara, respektivisht nga data 18 prill 2007 kur është privatizuar Ndërmarrja Shoqërore "I P".

AKP-ja gjithashtu thekson se ankuesja nuk ka paraqitur asnjë provë të parashtrimit të ndonjë ankese apo kërkesë në ndonjë gjykatë apo autoritet kompetent para përfundimit të periudhës së parashkrimit.

Sipas AKP-së e drejta për të kërkuar kompensimin e pagave të papaguara është parashkruar më 18 prill 2010.

Më 10 mars 2016 AKP-ja dorëzon mbrojtjen e saj ndaj ankesës së parashtrueses së dorëzuar më 31 janar 2014 kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRZ034-0272 të NSH ‘I P’ (në likuidim).

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar, dhe të vërtetojë (lë në fuqi) Vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRZ034-0272.

Më 23 prill 2019 Zyrtarja për Financa i ka dërguar paditëses Vërejtjen për pagesën e taksave gjyqësore duke kërkuar pagesën e taksës gjyqësore ashtu siç janë dhënë në procedurë ose të paraqesë prova që bën pjesë në kategorinë e të përjashtuarve nga kjo pagesë. Gjykata e njoftoi paditësen mbi pasojat e mospagimit të taksës gjyqësore.

Në bazë të fletëkthesave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga shërbimi postar është tentuar dy herë që të dorëzohet vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore, respektivisht më 26 prill 2019 dhe 13 shkurt 2020 por pa sukses. Në fletëkthesë është cekur se pala është shpërngulur.

Pas dështimit të dorëzim-pranimit të vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore, në bazë të nenit 26 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06 L-086 për Dhomen e Posaçme, nenit 116.5 dhe 116.6 të LPK-së, Zyra e Regjistrimit e DHPGJS-së e ka afishuar (publikuar) në tabelën e

shpalljeve vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore e cila ka qëndruar nga data 9 mars 2020 deri më 27 mars 2020.

Arsyetimi Ligjor

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086).

Padia e paditëses konsiderohet e tërhequr.

Bazuar në nenin 5.5.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, hyrë në fuqi më 01 maj 2017, për aplikimin e njëjtë të taksave gjyqësore, paditëses i kërkohet që brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga të shërbyerit dhe pranimi i urdhrit të gjykatës për t'ia dorëzuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës vërtetimin dhe faturën e pagesës të shumës së caktuar që duhet paguar ose që t'i dorëzojë gjykatës prova në lidhje me faktin se ai është i liruar nga pagesa për arsye ase është përfitues i ndihmës sociale nga ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ose Ndhimës Ligjore nga Zyra e Qarkut për Ndhimë Juridike.

Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, për unifikimin e tarifave gjyqësore, neni 5 paragrafi 5.1, parashikon detyrimin e të gjithë atyre që i drejtohen Gjykatës për të paguar taksat gjyqësore për procedimin në shumën e duhur.

Neni 8 i këtij Udhëzimi parasheh kategoritë e personave të cilët lirohen nga pagesa e taksës gjyqësore. Ndërsa paragrafi 8.3 i këtij Neni përcakton dokumentet që personat e liruar nga pagesa e taksës duhet t'i paraqesin gjykatës:

- a. dëshmi se ai/ajo është përfitues i ndihmës sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
- b. dëshmi se ai/ajo është duke marr ndihmë ligjore nga Zyra për Ndhimë juridike falas;
- c. dëshmi mbi statusin e familjarëve të dëshmorëve të UÇK-së dhe të zhdukurve;
- d. dëshmi mbi statusin e familjarëve të viktimave civile të luftës.

Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2017, Neni 5.5.2 parasheh që: *'nëse pas njoftimit, pala nuk i paguan taksat gjyqësore, sipas nenit 5.1 të këtij udhëzimi, gjyqtari i caktuar për çështjen, do të aplikojë nenin 253, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe si pasojë padia do të konsiderohet e tërhequr'*.

Paditësja përmes Vërejtjes për pagesën e taksave gjyqësore të datës 26 nëntor 2018 u informua për faktin se në bazë të nenit të lartpërmendur të Udhëzimit Administrativ, në rast të mos pagesës, ose në rast të mos paraqitjes në gjykatë, brenda afatit të caktuar prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, dëshmi se është përfitues i së drejtës për t'u liruar nga pagesa, Gjykata do të marrë një vendim duke e konsideruar çështjen në fjalë si të tërhequr.

Neni 26 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06 L-086 për Dhomën e Posaçme parasheh që: *‘Në rastet kur identiteti dhe/ose adresa specifike e një pale apo personi të caktuar nuk mund të vërtetohet përfundimisht, edhe pas përpjekjeve të kujdesshme e të arsyeshme, Gjykata lejon dorëzimin konstruktiv me ato mjete që mund të konsiderohen të arsyeshme në bazë të rrethanave. Mjetet e tilla mund të jenë dorëzimi me anë të publikimit në tabelën e shpalljeve, apo dorëzimi tek ndonjë i afërm i njohur apo tek një partner pune’.*

Gjykata ka provuar dy herë që të kryejë dorëzimin e vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore por pa sukses dhe në bazë të nenit 26 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06 L-086 për Dhomën e Posaçme ka urdhëruar Zyrën e Regjistrimit për të publikuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore në tabelën e shpalljeve të Gjykatës.

Neni 116 paragrafi 1 i Ligjit nr. 03 L-006 për Procedurën Kontestimore përcakton që: *‘Në qoftë se pala ose përfaqësuesi i saj, gjatë zhvillimit të procedurës apo para se të kalojë afati prej gjashtë muajsh pas përfundimit të procedurës me vendim të formës së prerë, e ndërrojnë adresën në të cilën bëhet dorëzimi i shkresave kanë për detyrë që për këtë gjë ta njoftojnë menjëherë gjykatën’.*

Për arsyet e lartcekura gjykata nuk është lëshuar fare në merita lidhur me këtë çështje.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**GJYQTARJA,
Manushe Karaçi**